



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**LEGJISLATURA VIII**

***Sesioni pranveror***

**Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim**

Mbledhja nr. 87

Prishtinë, më 2.7.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Besian Mustafa, Milazim Salijaj, Isak Shabani, Ekrem Mustafa, Salih Zyba, Jetmire Vrenezi dhe Albena Reshitaj.

Munguan: Samra Ilijazi dhe Ganimete Musliu.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga mediat

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

*Në këtë mbledhje u propozua ky :*

*Rend i ditës:*

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 28.5.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore;
6. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Komisioni, me 5 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, e miratoi rendin e ditës.*

**2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt. 28.5.2024**

*Komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, e miratoi procesverbalin nga dt. 28.5.2024*

### 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-275 për rrugët

*Kryetarja*, tha se raportin me amendamente për këtë projektligj, Komisioni e ka proceduar te komisionet e përhershme më 28.5.2024. Komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar dhe kanë rekomanduar se mund të procedohet më tutje.

*Meqë nuk pati vërejtje, ajo i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 5 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Komisioni nxori këtë:*

*Përfundim*

*Komisioni vendosi që Raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 08/L-275 për rrugët, procedohet në seancë plenare për lexim të dytë.*

### 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për automjete

*Kryetarja* e paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete dhe tha se ky projektligj është nismë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, i ka 4 nene dhe ka për qëllim të ndryshojë 2 nene të Ligjit në fuqi për Automjete, si në vijim:

**“Në nenin 44** të Ligjit për Automjete, paragrafi 2 dhe 3, të shkrihet në një paragraf, si vijon:

2. Në Kosovë nuk mund të importohen vetura të cilat nuk e plotësojnë standardin Euro pesë (5).

**Në nenin 63** të Ligjit për Automjete, paragrafi 1 dhe 2, formulohet si vijon:

1. Ç lajmërimi i mjetit për shkak të ndërrimit të pronarit është i mundur vetëm nëse në të njëjtën kohë regjistrohet pronari i ri i mjetit në evidencë dhe bartet pjesa e mbetur e regjistrimit të mjetit.
2. Gjatë bartjes së pronësisë, pronari i ri e regjistron mjetin në emër të tij, në afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh nga data e blerjes së mjetit, dhe bartet pjesa e mbetur e regjistrimit të mjetit.”

Sipas opinionit për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Drejtoria e Buxhetit të Kuvendit, projektligji nuk do të ketë kosto shtese buxhetore. Ndërsa, sipas opinionit ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nga Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të legjislacionit, dispozitat e këtij Projektligji nuk i cenojnë parimet bazë të legjislacionit të BE-së. Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit.

Ajo shtoi se sipas informatave që ka, Ministria e Mjedisit është në fazën finale të hartimit të projektligjit të ri për automjete i cili përveç çështjes së vjetërsisë së veturave që importohen, adreson edhe plotë çështje të tjera. Çështja e fermerëve për regjistrimin e mjeteve, kërkesa e motoristëve për regjistrimin e motorëve dhe ka çështje të kategorive të tjera që nuk mund të adresohen vetëm me këto dy ndryshime. Prandaj, duke parë problemet që janë adresuar mendoj që ky projektligj nuk do të duhej të kalojë dhe se do të duhej të jetë një ligj i ri, i cili do të plotësohej në tërësi dhe jo një ligj që të ndryshohet në dy apo tri çështje.

**Salih Zyba**, tha se një iniciativë e tillë ka qenë edhe së paku dy herë dhe se nuk e ka marrë mbështetjen në seancë në mandatet e kaluara dhe se është kundër këtij ndryshim plotësimi, pasi sipas tij, kjo nismë e trajton këtë projektligj vetëm në mënyrë të pjesshme. Ky ndryshim i shpejt nuk i bënë shërbim qytetarëve dhe se Ligjin duhet ta shohim në tërësi. Grupet e interesit kanë kërkesa për ndryshime rrënjësore sepse ligji është i stërvjetëruar. Nuk e konsideroj të mjaftueshëm t’i japim mbështetje një nisme kaq të pjesshme vetëm me dy nene.

**Isak Shabani**, tha se e përkrahi këtë projektligj, pasi që jam edhe vet nënshkrues i kësaj iniciative të këtij ndryshim plotësimi të ligjit. Kjo kërkesë për ndryshim ka qenë edhe kërkesë e qytetarëve, ndërsa shtoi se Ligji i ri që u tha se do të vjen nga Qeveria, nuk dihet se kur vjen dhe

se kjo kërkon kohë dhe brenda viti ndoshta nuk vjen. Prandaj, nëse kjo nismë kalon tash nuk e pengon që kur të vjen ligji i ri të inkorporohen edhe këto ndryshime.

**Ekrem Mustafa**, këtu janë propozua në dy nene me ndërhy, me njërin ndoshta nuk na kish pengu, ndërsa të vjetërsia e automjeteve duhet me prek edhe nene tjera. Nëse e marrim automjetin më të vjetër se 20 vjet, nuk me kish pengu vjetërsia e automjetit, por gjendja e tij. Në kontrollim teknik nuk është obliguese matja e ndotjes së ambientit, pra e gazrave, ata e matin vetëm sa për sy e faqe dhe ketë duhet bërë obliguese.

**Kryetarja**, shtoi se drafti i ministrisë i cili është duke u përgatitur, i adreson të gjitha këto çështje siç janë ndotja e ambientit dhe kontrollin teknik dhe në sesionin vjeshtor do ta kemi në shqyrtim në komision. Pas diskutimeve, ajo tha se sipas rregullores së Kuvendit, ne si komision mund t'ia rekomandojmë Seancës, miratimin ose mosmiratimin në parim të projektligjit.

*Ajo i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 1 votë për, 5 kundër dhe 1 abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë*

*Rekomandim:*

*Të mos miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-306 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete.*

## **5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore**

**Kryetarja** e paraqiti për shqyrtim projektligjin dhe tha, se ky Projektligj i ka 170 nene dhe ka për qëllim: “të përcaktojë statusin juridik të ujërave, tokës ujore dhe objekteve ujore si dhe të përcaktojë rregullat për menaxhimin e cilësisë dhe sasisë së resurseve ujore, shfrytëzimin dhe shpërndarjen e resurseve ujore, mbrojtjen e resurseve ujore, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, veprimtarinë e menaxhimit të resurseve ujore si dhe organizimin institucional me qëllim të mbrojtjes së resurseve ujore të Republikës së Kosovës nga ndotja tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi dhe për të siguruar ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre e duke pasur parasysh se resurset ujore janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Kosovës.”

Pastaj shtoi se sipas opinionit për vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Financave, projektligji nuk do të ketë kosto shtese buxhetore. Ndërsa, sipas opinionit ligjor të përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, Projektligji pjesërisht transpozon dispozitat e acquis të BE-së, Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 71 të Rregullores së Kuvendit.

**Besian Mustafa**, tha se më çuditi se si raporti financiar thotë se nuk ka implikime financiare.

**Albena Reshitaj**, tha se është projektligj ndër më të rëndësishmit nga fusha e mjedisit dhe ndoshta është pak i vonuar, pasi që është dashtë të jetë ndër prioritetet e MMPHI-së sepse pa pasur një ligj për menaxhimin e resurseve ujore dhe se çdo vendim, pa të ka qenë në dëm të ujërave dhe të biodiversitetit. Jo rastësisht, tha se vendimi im si ministre e mjedisit ka qenë për ti ndërprerë lejet për hidrocentrale, sepse kam dashtë që fillimisht ta ketë një ligj për menaxhimin e resurseve ujore, të dimë saktë burimet ujore, sasinë, cilësinë dhe gjendjen e ujërave në Kosovë si dhe ta dimë se ku mund të investojmë. Dëmi në të kaluarën ka qenë i madh në mjedis në ujëra dhe biodiversitet. Dilema në lidhje me financat, sesi janë bërë investime shumë në të kaluarën edhe nga investitorë të huaj, siç janë Qeveria Zvicerane dhe ka shumë implikime financiare dhe nuk e di si ka dalë që nuk ka implikime financiare. Prandaj, tha se duhet përkrahur ky projektligj.

**Kryetarja** edhe njëherë e përsëriti se deklarata financiare thotë, se nuk do të ketë shpenzime shtesë.

**Salih Zyba**, pyeti se cili është implikimi buxhetor i këtij ligji?

**Besian Mustafa**, tha se Raporti financiar nga Ministria e financave identifikon katër njësi organizative, që janë bartëse të implementimit siç janë: Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore,

Departamenti i Mjedisit, Departamenti i Inspektoratit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit dhe këto për KASH për tri vite janë të planifikuara afër 44 milionë euro shpenzime. Pra, raporti thotë se nuk ka shpenzime shtesë. Mirëpo, ai shtoi se nëse ligji ka qenë i suksesshëm në menaxhimin e resurseve ujore, pyetja është pse kemi ligj të ri dhe s'kemi shpenzime shtesë.

*Pas diskutimeve, kryetarja i ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë*

*Rekomandim:*

*Të miratohet në parim Projektligji nr. 08/L-311 për menaxhimin e resurseve ujore.*

## **6. Të ndryshme**

Deputeti **Isak Shabani**, e paraqiti një shkresë dërguar atij përmes e-malit nga z. Xhezair Bibaj, me ankesën dhe informimin e tij, iu ka dërgua edhe disa deputetëve tjerë, këtë e konfirmuan edhe deputetët Besian Mustafa dhe Salih Zyba.

**Kryetarja**, konstatoi se e-malin me përmbajtje që e paraqiti deputeti Isak Shabani, së pari do t'ia përcjellë administratës së komisionit dhe ata ia shpërndajnë të gjithë deputetëve, me qëllim që në një mbledhje tjetër të trajtohet dhe të marrim vendim se çfarë të bëjmë.

Deputeti **Salih Zyba**, tha se duhet të kërkohet një raport nga MBPZHR-ja për korrje- shirjet në vend dhe mundësisht të ftohet ministri në komision për mbledhjen e radhës.

**Kryetarja**, pasi që është koha e korrje-shirjeve dhe ata janë në proces, duhet të presim të përfundojë për ta pasur një raport të duhur për këtë. Më së miri është që në mbledhjen e parë të sesionit tjetër të kërkojmë raport dhe të ftojmë ministrin e MBPZHR-së në raportim.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:10.*

*E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit*

***Fitore Pacolli-Dalipi,***

***Kryetare e Komisionit***